

# Blerjet e Perqendruara

Prezantim  
Av. Muharem Çakaj  
Av. Elton Lula

## Agjencia e Blerjeve të Përqendruara

Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, është person juridik publik, buxhetor, në varësi të ministrit të Brendshëm, me seli në Tiranë dhe organizohet dhe funksionon si Institucion Qendror.

Misioni i Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara është kryerja e procedurave të prokurimit të fondeve buxhetore me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrive, institucioneve në varësi të Kryeministrit e të ministrave të linjës, për blerjen e **mallrave** dhe të **shërbimeve** të përcaktuara në aktin nënligjor përkatës, si organ qendror blerës, i autorizuar me vendim të Këshillit të Ministrave

## Kompetencat e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara janë si më poshtë:

Në rastin kur kryen procedura prokurimi për të nënshkruar marrëveshje kuadër:

- a) zhvillon procedurat e prokurimit deri në nënshkrimin e marrëveshjes kuadër;
- b) përlogarit fondin limit për mallrat dhe shërbimet që do të prokurohen;
- c) unifikon specifikimet teknike për mallra dhe shërbime të të njëjtit lloj, në përputhje me standardet e miratuara, në bashkëpunim me specialistët e fushave, të institucioneve përgjegjëse ose specialistë të jashtëm, vendës a të huaj, dhe harton katalogët e standardeve, të cilët miratohen me udhëzim të ministrit;
- ç) shqyrton ankesat e operatorëve ekonomikë deri në nënshkrimin e marrëveshjes kuadër;
- d) në rast se autoritetet kontraktore kanë kërkesa për kryerjen e procedurës së prokurimit, pasi është bërë publikimi i njoftimit të kontratës së prokurimit, Agjencia verifikon arsyet e vonesës, shpall procedurën e re të prokurimit për këto kërkesa dhe njofton Agjencinë e Prokurimit Publik;
- dh) monitoron, në çdo kohë, zbatimin e kontratave nga autoritetet kontraktore dhe për këtë qëllim harton një raport për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, një kopje e të cilit i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik

Në rastin kur Agjencia kryen procedura prokurimi për të lidhur kontratë, ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- a) Zhvillon procedurat e prokurimit të përqendruar të mallrave;
- b) Bashkërendon punën me autoritetet kontraktore për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave për prokurimet publike që do të zhvillojë si organ qendror blerës;
- c) Unifikon specifikimet teknike për mallra dhe shërbime të të njëjtit lloj, në përputhje me standardet e miratuara;
- ç) Verifikon përputhshmërinë e kërkesave të dërguara nga autoritetet kontraktore me ligjin dhe standardet në fuqi;
- d) Përllogarit fondin limit për përcaktimin e të dhënave sasiore për mallrat dhe shërbimet që do të prokurohen, para publikimit të tenderit, dhe vë në dijeni autoritetet kontraktore;
- dh) Shqyrton ankesat e operatorëve ekonomikë deri në shpalljen e njoftimit të fituesit;
- e) Në rast se autoritetet kontraktore kanë kërkesa për kryerjen e procedurës së prokurimit, pasi është bërë publikimi i njoftimit të kontratës së prokurimit, Agjencia verifikon arsyet e vonesës, shpall procedurën e re të prokurimit për këto kërkesa dhe njofton Agjencinë e Prokurimit Publik;
- ë) Monitoron në çdo kohë zbatimin e kontratave nga autoritetet kontraktore.
- f) Harton një raport për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, një kopje e të cilit i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

## **Produktet që Prokurohen nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara:**

Llojet e kontratave të mallrave dhe shërbimeve, për të cilat Agjencia e Blerjeve të Përqendruara kryen procedurat e prokurimit janë si më poshtë:

- 1.1. Blerje automjetesh;
- 1.2. Blerje karburanti, përveç vajgurit *Jet A1*;
- 1.3. Blerje materialesh kancelarie;
- 1.4. Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim zyrash;
- 1.5. Blerje materialesh të ndryshme për pastrim;
- 1.6. Blerje uniformash dhe elementesh të tjera përbërëse të tyre;
- 1.7. Blerje këpucësh;
- 1.8. Blerje pjesësh këmbimi për automjete, për shërbimet profilaktike;
- 1.9. Blerje tonerash;
- 1.10. Sigurim automjetesh;
- 1.11. Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi;
- 1.12. Shërbim pastrimi;
- 1.13. Shërbim lysterje dhe mirëmbajtjeje ndërtesash;
- 1.14. Riparim dhe mirëmbajtje automjetesh;
- 1.15. Botime, printime dhe materiale shtypshkrimi;
- 1.16. Blerje materialesh të buta dhe veshmbathje;
- 1.17. Riparim, mirëmbajtjeje sistemi të ngrohje-ftohjeve;
- 1.18. Mirëmbajtje impiantesh elektrike;
- 1.19. Blerje pajisjesh laboratorike, me përjashtim të atyre mjekësore;
- 1.20. Shërbime dezinfektimi;
- 1.21. Shërbim i ruajtjes dhe i sigurisë fizike;
- 1.22. Blerje artikujsh ushqimorë;
- 1.23. Blerje pajisjesh kondicionimi;
- 1.24. Shërbim gjelbërimi;

### **Avantazhet e blerjes se perqendruar:**

- a) Unifikim i specifikimeve teknike, pra për të njejta mallra apo shërbime që do të përfitojnë autoritetet kontraktore do të kemi cilësi e standard të njëjtë;
- b) Përfitim ekonomik nga Ofertat e operatorëve ekonomike, për arsye se duke qenë se Agjencia e Blerjeve të Përqendruara prokuron të gjitha sasi të nevojshme për institucionet e sipërcituara, e rjedhimisht oferta ekonomike për sasi të mëdha do të jetë më e leverdishme.

Në rastin e marrëveshjes kuadër, do të kemi plotësimin pa shkëputje të nevojave për mallra e shërbime (sidomos ato të vazhdueshme si psh: shërbim furnizimi me ushqim, shërbim roje; shërbim pastrimi etj);

### **Dizavantazhet e blerjes se perqendruar :**

Dizavantazhi kryesor i kësaj skeme prokurimi, është se në rast dështimi të realizimi të kësaj procedure prokurimi (psh anulim procedure nga KPP, mos ofertim nga operatorët ekonomikë etj) atëhere autoritetet kontraktore do të duhet të plotësojnë nevojat e tyre për mallra e shërbime me metoda të tjera të prokurimit publik si negociim pa shpallje. Kjo do të çojë në rillogaritje të sasisë, fondit limit etj pasi do zbritet sasia e prokuruar nga vetë autoriteti.

# Praktika ndërkombëtare per Blerjet e Përqendruara

Argumentet kryesore që zakonisht paraqiten në mbështetje të prokurimit të përqëndruar janë:

- Ulje të ndjeshme në çmimet e mallrave dhe shërbimeve;
- Shërbime më të mira me kosto më të ulët;
- Rritja e fuqisë blerëse për agjencinë e përqëndruar;
- Nevoja për standardizimin teknik (p.sh., brenda fushës së sistemeve të IT dhe aplikacioneve kompjuterike (softëare) dhe
- përcaktimin dhe përfshirjen e standardeve mjedisore për prokurimet qeveritare;
- Përfitimet pa kosto duke përfshirë vëmendjen më të madhe për menaxhimin e kontratave dhe zgjidhjen më të mirë të problemeve;
- Kosto më të ulëta të stafit të trajnimit sepse ato janë më pak në numër dhe të vendosura në nivel qendror;
- Menaxhim më i lehtë i performancës së stafit; dhe
- Nxitje e dispozitave të mira të transparencës, siç është regjistrimi efikas dhe raportimi i kontratat dhe transaksionet e prokurimit, kontrollet efektive të menaxhimit, gjurmët e auditimit më të qartë.



Argumentet kryesore në mbështetje të prokurimit të decentralizuar janë:

- Zvogëlimi i stimujve për korrupsion përmes proteksionizmit ose favorizimeve në shkallë të gjerë;
- Përputhja më e afërt e kërkesave për mallra apo shërbimet e ofruara me nevojat e specializuara të do autoriteti, në referencë të përdoruesve fundorë;
- Zvogëlimi i fushëveprimit për gabime që ndikojnë në blerjet e volumit të madh që rezultojnë me shpenzime të tepërta të panevojshme;
- Më pak burokraci për shkak të afateve më të shkurtra kohore dhe formave më të pakta për blerësit dhe furnitorët;
- Mundësi më të mëdha për SME-të që të konkurrojnë me sukses për kontratat;
- Mundësitë për autoritetet vendore për të marrë çmime më të ulta për mallrat e prodhuara në vend; dhe
- Më shumë hapësirë për punonjësit për të marrë përgjegjësi individuale dhe për të zhvilluar një mentalitet "shërbimi".

**DANIMARKA** nuk ka një agjenci të veçantë me mandat për blerje në emër të autoriteteve të tjera qeveritare. Megjithatë, ekziston një sistem për përdorim qendror dhe bashkërendim të marrëveshjeve kuadër. Kur Agjencia e Prokurimit të Qeverisë u themelua në vitin 1976 nën përgjegjësinë e Ministrisë së Financave, ajo mori përsipër marrëveshje kuadër si një mjet për pajisjen e organeve qeveritare me mallra dhe shërbime.

Megenëse Direktiva e Shërbimeve thotë se marrëveshjet kuadër nuk mund të keqpërdoren, qeveria daneze konsultoi Komisionin kur në 1995 Agjencia e Prokurimit të Qeverisë në vitin 1995 u bashkua me një njësi të ngjashme komunale në mënyrë që të kujdeseshin për entitetet qeveritare dhe komunale. Ky entitet i ri, Shërbimi i Prokurimit për Shtet dhe Komunat (SKI), është një kompani private në pronësi të Ministrisë së Financave dhe Organizatës Kombëtare të Komunave. Komisioni nuk ka kundërshtuar këtë centralizim të mëtejshëm, pasi bashkimi nuk u gjet për të kërcënuar konkurrencën ose aksesin e lirë në tregun publik

**FINLANDA.** Politika dhe legjislacioni aktual kanë tendencë të promovojnë procedurat e përqendruara.

Organi i Blerje Të Përqndruara Qeveritare u krijua në vitin 1941. Ajo veprroi si autoritet publik deri në vitin 1995, kur një ndryshim në legjislacion lejoi të përfshihej si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të quajtur Trading House Hansel Ltd (Hansel).

Nga vitet 1960 ishte e detyrueshme për entitetet e prokurimit të qeverisë shtetërore, por jo autoritetet vendore, për të prokuruar nëpërmjet Qendrës. Që nga themelimi i Hansel, klientët e sektorit publik kanë pasur të drejtë të vendosin nëse do të përdorin shërbimet e tyre ose jo. Subjektet qeveritare të shtetit lejohen të urdhërojnë direkt nga Hansel pa procedura të reja tenderuese.

Nga fillimi i viteve 1990 ka pasur një tendencë të fortë drejt decentralizimit të administratës publike, duke përfshirë prokurimin publik dhe një theks mbi menaxhimin sipas rezultateve.

## GJERMANI

Në Gjermani, prokurimi tradicionalisht është kryer në baza të decentralizuara. Për shkak të kufizimeve të fundit financiare, megjithatë, disa institucione publike, veçanërisht komunat, kanë konsideruar mënyra alternative të prokurimit të mallrave dhe shërbimeve për të arritur kursime. Disa bashki, p.sh. në Saksoninë e Ulët, kanë themeluar organe të përqëndruara të prokurimit të cilat mund të marrin forma të ndryshme, p.sh. kompanitë me përgjegjësi të kufizuar (Gesellschaft mit beschränkter Haftung), kooperativat dhe partneritetet. Krijimi i organeve të përqëndruara të prokurimit por kritikohet për efekt të zbatimit të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

## ITALIA

Legjislacioni i brendshëm i Italisë në fushën e prokurimit publik daton nga vitet 1920 dhe është ende në fuqi, megjithëse shumë i ndryshuar me legjislacionin pasues. Ai rregullon prokurimin e qeverisë qendrore në përgjithësi dhe parashikon procedurat e tenderit publik për zgjedhjen e kontraktorëve të ngjashëm me dispozitat e përcaktuara nga Direktivat e Komunitetit (Royal Decrees 2440/1923 dhe 827/1924). Ky legjislacion përcakton rregullat e përgjithshme të cilat formalisht janë të detyrueshme vetëm për qeverinë qendrore, por që përdoren gjithashtu si referencë nga qeveritë rajonale dhe lokale. Për shkak të shqetësimeve rreth përfshirjes së krimit të organizuar në kontratat e prokurimit publik, ka legjislacion specifik të hartuar për të parandaluar dhënien e kontratave qeveritare për individët që i përkasin apo dyshohen se i përkasin organizatave mafioze. Pas një reforme të madhe që i jep autonomi më të madhe organizatave të qeverisjes vendore (komunave dhe provincave) të nisura në vitin 1990 dhe ende në proces, autoritetet lokale tani mund të miratojnë rregulloret e tyre specifike në fushën e prokurimit publik

## **HOLANDA**

Rijks Inkoop Bureau (RIB) e Holandës është themeluar në vitin 1921. Qëllimi i kësaj zyre qendrore të prokurimit të qeverisë ishte shpenzimi efikas i buxhetit të qeverisë. Fillimisht, përgjegjësitë e BRIB mbulonin vetëm një numër të kufizuar mallrash. Megjithatë, në vitet 1949, 1967 dhe 1980, u miratuan ndryshime në ligj, duke rritur numrin dhe llojin e mallrave të mbuluara nga RIB si dhe zgjerimin e gamës së klientëve të saj. Në vitet 1980, në Holandë filluan diskutime në lidhje me forcimin e ekonomisë së tregut dhe liberalizimin e lidhur ekonomik, derregulimin, privatizimin dhe ndryshimin e rolit të qeverisë në ekonomi. Faktorë pozitivë si bashkëpunimi më i gjerë ndërkombëtar dhe faktorët negativë si falimentimi i ekonomive të planifikuara nga qendra e përforcuan këtë prirje. Rritja e konkurrencës ndërkombëtare u konsiderua e rëndësishme jo vetëm për sektorin privat, por gjithashtu - dhe gjithnjë e më shumë - për pjesë të sektorit publik. Si rezultat i këtij diskutimi, BRI u privatizua më 1 janar 1990 dhe u quajt "Nederlands Inkoopcentrum" (NIC). Në të njëjtën ditë, u shfuqizua akti ligjor që parashikonte që të gjitha organizatat qeveritare të përdorin shërbimet e RIB/NIC. Punonjësit e NIC nuk u klasifikuan më si nëpunës civilë dhe organizata e sapo krijuar duhet të vepronte si një kompani private. Klientët potencial duhej të gjendeshin në sektorin publik dhe atë privat. NIC filloi aplikimin e tarifave për shërbimet e kryera. Megjithëse NIC ishte i suksesshëm në negocimin e marrëveshjeve kuadër me disa ente të mëdha qeveritare, ajo hasi disa humbje në vitet e para të funksionimit të saj. Sektori publik mbetet fokusi kryesor i interesit për shkak të njohjes së programeve të shpenzimeve publike, ekspertizës mbi mallrat e veçanta dhe marrëdhënieve të vjetra të vendosura me organet shtetërore.

## **SUEDI**

Suedia nuk ka një agjenci të veçantë me mandat për të blerë në emër të autoriteteve të tjera qeveritare. Sidoqoftë, ekziston një sistem për përdorim qendror dhe bashkërendim të marrëveshjeve kuadër me aplikimin e ftesave për prokurime për subjektet kontraktuese brenda sektorit qeveritar.

Sipas një marrëveshjeje kuadër, çmimet dhe të gjitha kushtet e tjera kontraktuale përveç sasive janë rënë dakord paraprakisht ndërmjet furnizuesit dhe autoritetit kontraktues.

Organi bashkërendues për administrimin e marrëveshjeve kornizë është Agjencia Ligjore, Financiare dhe Administrative (Kammarkollegiet). Rolin e tij janë (1) të sigurojnë që marrëveshjet kuader të përdoren për furnizimet që autoritetet kontraktuese shpesh kanë nevojë (p.sh. pajisje zyre, kompjutera, letra), dhe (2) të monitorojë përdorimin e marrëveshjeve kuadër përmes përpilimit të statistikave dhe masave të tjera

## **SERBIA**

Ligji i Prokurimit Publik, i miratuar në vitin 2013, i ndryshuar në vitin 2015, ka përmirësuar kuadrin ligjor në këtë fushë dhe ka prezantuar një organ qendror blerës që merret me prokurimet për organet shtetërore, ka prezantuar risitë në prokurimin e përqendruar publik dhe shkurtimin e afateve për veprime specifike në procedura. Njoftimet e prokurimeve publike dhe procedurat e dhënies së kontratës janë harmonizuar me direktivat e BE-së

## **KROACIA**

Organi publik qendror blerës, sipas ligjit kroat për prokurimin publik përdoret në rast se Autoritetet dëshirojnë të prokurojnë furnizime, punë dhe/ose shërbime nga ose brenda organit qendror blerës publik. Organi publik qendror blerës është një autoritet kontraktues që: 1. Prokuron furnizime dhe/ose shërbime të destinuara për autoritetet kontraktore. Autoritetet kontraktore mund të autorizojnë një autoritet tjetër kontraktor që të kryejë procedurën e prokurimit publik. Me qëllim të prokurimit të përbashkët, disa autoritete kontraktore mund të autorizojnë një prej tyre ose një autoritet të tretë kontraktor që të kryejë procedurën e prokurimit publik.

## **KOSOVA**

Në Ministrinë përgjegjëse për Financat është krijuar Agjencia Qendrore e Prokurimit (“AQP”). Për shkaqe të ekspertizës profesionale, efektivitetit të kostos, efikasitetit ose çështjeve të tjera legjitime, Ministri për financa mund të ketë autoritetin për ta përcaktuar AQP-në si autoritetin kontraktues përgjegjës për kryerjen e atij aktiviteti prokurimi. Në një rast të tillë Ministri i financave njofton autoritetin përkatës kontraktues ose autoritetet, të cilat nuk janë më të autorizuar të kryejnë prokurimin në fjalë, dhe AQP, për të gjitha qëllimet e ligjit aktual, do të konsiderohet “autoriteti kontraktues” për aktivitetin në fjalë të prokurimit. Qeveria sipas propozimit të Ministrisë për Financat vendos një listë të mallrave ose artikujve të përdorimit të përbashkët, prokurimi i të cilëve i është caktuar AQP. Kjo listë miratohet në formën e një Udhëzimi Administrativ. Kjo listë dhe çdo ndryshim i saj duhet të publikohen në media dhe të shpallen në faqen e internetit të organit rregullator të prokurimeve publike. Një autoritet kontraktor porosit AQP-në për mallrat, punët ose shërbimet e prokuruar nga AQP në bazë të këtij ligji dhe nuk kryen aktivitet prokurimi për to. Një autoritet kontraktor mund të caktojë AQP-në për kryerjen e një aktiviteti prokurimi në emër të tij. Autoriteti kontraktues gjithashtu mund të kërkojë nga AQP të ndihmojë atë për kryerjen e aktivitetit të prokurimit që kryhet nga ky autoritet kontraktues